



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë, 28/05/2024

**UDHËZIM PËR ZGJEDHËSIT**

**“Mbi zhvillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese në të gjitha njësitë e Universitetit të Tiranës”**

Bazuar në nenin 6 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës”, datë 10.02.2020, Kreu II, neni 6, pika 2, germa “a”.  
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të UT-së:

**UDHËZON:**

1. Votimet për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në UT zhvillohen më datë, 21.06.2024 e caktuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit për proceset zgjedhore të radhës.
2. Dita para datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve deri në mbylljen e votimit, formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore.
3. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore.
4. Administratori i Njesisë kryesore dhe KZF-të e njësive të UT-së janë përgjegjës për garantimin e standardeve zgjedhore.
5. Administratorët e njësive duhet të japin mbështetjen e tyre, që në mjediset ku do të ngrihen qendrat e votimit, të ketë një vend-hyrjeje dhe një vend-daljeje për zgjedhësit.



6. Në mjediset përreth Qendrave të Votimit është e ndaluar rreptësisht prezenca e materialeve të fushatës zgjedhore nga secili kandidat garues.
7. Në mjediset e Njësive kryesore gjatë ditës së zgjedhjeve është e ndaluar kategorikisht fushata në mbështetje të kandidatëve garues. Personeli i administrimit në njësitë kryesore të UT-së, duhet të marrë masat e nevojshme, në komunikim me KZF-në e njësisë, ku po zhvillohet procesi i votimit.
8. Qendra e Votimit hapet në orën 8:00 dhe mbyllet zyrtarisht në orën 16.00. Nëse edhe pas orës 16.00 ka zgjedhës që presin në radhë, KZF/KQV-ja mbledh dokumentet e identifikimit të të gjithë zgjedhësve të pranishëm dhe i thërret ata me radhë për të kryer votimin. Asnjë zgjedhës tjetër nuk do të lejohet të votojë, nëse nuk ka qenë në radhë në kohën e mbledhjes së dokumentit të identifikimit.
9. Zgjedhësit ndjekin sinjalistikën për t'u drejtuar në qendrën e tyre të votimit, respektojnë radhën jashtë Qendrës së Votimit, duke respektuar sinjalistikën e vendosur në mjediset universitare, sikurse dhe futen, njëri pas tjetrit, në qendrën e votimit për të votuar, me thirrjen nga një anëtar i Komisionit të Qendrës së Votimit.
10. Në Qendrën e Votimit është i ndaluar kategorikisht përdorimi i celularit si nga zgjedhësit, ashtu edhe nga anëtarët e komisioneve zgjedhore, me përjashtim të kryetarit të KZF-së apo anëtarit të ngarkuar nga KZF-ja, si koordinator me KIZ.
11. Zgjedhësit e trupës zgjedhore të kategorisë “personel akademik”, paraqiten para KZF-së të Njësive kryesore duke u identifikuar, duke deklaruar Njësinë bazë, ku bëjnë pjesë dhe duke paraqitur para KZF-së të Njësive kryesore përaktëse të UT-së një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit, si: Kartë Identiteti ose Pasaportë
12. Zgjedhësit e trupës zgjedhore të kategorisë “student”, paraqiten para KQV-së duke u identifikuar, duke deklaruar programin ku bëjnë pjesë dhe duke paraqitur para komisionit një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit, si: Kartë Identiteti, Pasaportë ose Kartë Studenti, përveç studenteve të Filialit Sarandë të UT-së që si QV kanë KZF-në .
13. Kryetari i KZF/KQV-së verifikon se të dhënat e identitetit të votuesit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit. Kryetari shënon në listën e zgjedhësve, llojin dhe numrin e serisë së dokumentit të identitetit dhe më pas vendos vizë në të dhënat e zgjedhësit në këtë listë.
14. Personeli Akademik me kohë të plotë ose Studenti, që është i pajisur nga një Vendim të KIZ-it për të votuar, pasi hyn në QV-në, e paraqet atë te kryetari i Komisionit të Qendrës të Votimit.



Emri i këtij zgjedhësi dhe numri i kartës së identitetit të tij shënohet në Fletoren e Protokollit të Ditës së Votimit, që më pas futet në Kutinë e Materialeve dhe Dokumenteve të Votimit për dorëzim në KIZ.

15. Zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve përbri emrit të tij.
16. Zgjedhësit e trupës zgjedhore të kategorisë “student” në Njësitë kryesore të UT-së dhe Filialin e Sarandës, i jepet për të votuar fleta e votimit:
  - i. për rektor të UT-së;
  - ii. për drejtues të njësisë kryesore përkatëse të UT-së;
  - iii. për anëtar të Senatit Akademik të UT-së, përfaqësues i studentëve, nga kategoria “student”.
17. Zgjedhësit e trupës zgjedhore të kategorisë “personel akademik” me kohë të plotë në Njësitë kryesore të UT-së, i jepet për të votuar fleta e votimit:
  - i. për rektor të UT-së;
  - ii. për drejtues të Njësisë kryesore të UT-së;
  - iii. për drejtues të Njësisë bazë të UT-së;
  - iv. për anëtar të Senatit Akademik të UT-së nga personeli akademik i Njësisë kryesore përkatëse të UT-së.
18. Zgjedhësit e trupës zgjedhore të kategorisë “personel akademik” me kohë të plotë në Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, i jepet për të votuar fleta e votimit:
  - i. për rektor të UT-së;
  - ii. për drejtues të Qendrës së kërkimit shkencor në të cilën bëjnë pjesë.
19. Zgjedhësit e trupës zgjedhore të kategorisë “personel akademik” me kohë të plotë në Filialin e Sarandës të UT-së, i jepet për të votuar fleta e votimit:
  - i. për rektor të UT-së;
  - ii. për drejtues të Njësisë kryesore përkatëse të UT-së;
  - iii. për anëtar të Senatit Akademik të UT-së nga personeli akademik i Njësisë kryesore përkatëse të UT-së.
20. Çdo fletë votimi është e vulosur, në pjesën e pasme të saj, me vulën e KZF-së dhe KQV-së (kur ka të tilla).
21. Zgjedhësi, pasi merr fletët e votimit, hyn i vetëm në dhomën e fshehtë:
  - i. në fletën e votimit për drejtues të njësisë kryesore/njësisë bazë shënon në krah të emrit të kandidatit vetëm një nga tri shenjat: “+” ose “x” ose “√”. Shenja duhet të vendoset vetëm në krah të një emri. Në rastin kur për autoritet drejtues konkurron vetëm një kandidat, zgjedhësi



voton duke shënuar vetëm shenjat e mësipërme në një nga alternativat e shënuara krahas emrit të kandidatit "Pro" ose "Kundër";

ii. në fletën e votimit për anëtar të Senatit Akademik shënon, në krah të emrave të kandidatëve vetëm një nga këto tri shenja "x" "+" "√". Zgjedhësi e trupës zgjedhore të kategorisë "personel akademik" dhe të kategorisë "student" duhet të shënojë jo më shumë emra (4 (katër)), sesa është numri i mandateve në Senatin Akademik që i përkasin Njesisë kryesore përkatëse dhe anëtarit në SA, përfaqësues i studentëve, nga kategoria e studentëve.

iii. pasi bën shënimin e tij në fletën e votimit, ai i palos fletët në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, por duhet të jenë të dukshme vula/vulat e KZF-së dhe KQV-së, del nga dhoma e fshehtë, i hedh fletët në kutitë përkatëse të votimit dhe largohet nga Qendra e Votimit.

22. Zgjedhësi nuk lejohet të fusë fletën/fletët e votimit në kuti, nëse shënimin në fletën e votimit ose, së paku, në një nga fletët e votimit bëhet jashtë dhomës së fshehtë. Kryetari i Qendrës së Votimit e merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët "E dëmtuar" dhe e fut atë në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara". Në këtë rast zgjedhësit i jepet një fletë votimi tjetër, e të njëjtit lloj, dhe rasti mbahet shënim në librin e protokollit të mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi. Nëse zgjedhësi bën shënim ose e dëmton fletën e votimit pa dashje dhe kërkon një fletë votimi të dytë, fleta e votimit konsiderohet "e dëmtuar" dhe futet në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit i jepet një fletë votimi e dytë. Rasti mbahet shënim në librin e protokollit të mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon ose e dëmton përsëri pa dashje fletën e dytë të votimit, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi. Në asnjë rast fletët e votimit të dëmtuara dhe të pavlefshme nuk hidhen në kutitë e votimit.

23. Në Qendrën e Votimit ndalohet kategorikisht përdorimi i aparateve celulare apo i mjeteve të tjera regjistruese. Zgjedhësi duhet të hyjë në dhomën e fshehtë i pangarkuar me çanta, mjete apo sende, qoftë edhe shkollore.

24. Në qendrën e votimit, gjatë procesit të votimit lejohen të qëndrojnë vetëm:

- anëtarët dhe sekretari i KZF/KQV-së;
- zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit deri në përfundim të tyre;
- vëzhguesit e akredituar nga KIZ;

26. Në qendrën e votimit, gjatë procesit të numërimit të votave lejohen të qëndrojnë vetëm:

- anëtarët dhe sekretari i KZF-së;



- kandidati/kandidadët garues ose vëzhguesi/vëzhguesit e tyre të akredituar nga KIZ;
- vëzhguesit, nga organizata joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara dhe të angazhuara për mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësues të ministrisë së linjës ose të medias, e akredituar nga KIZ.

27. Kryetari i KZF-së, në rast të shkeljes së rregullit dhe qetësisë nga pjesëmarrësit e lejuar në të, gjatë numërimit, ndërpret procesin e numërimit, bën mbledhjen urgjente të KZF-së dhe merr vendimin përkatës për personin që cënon respektimin e standardeve zgjedhore. Për vendimin komunikon me KIZ dhe ky i fundit komunikon me Administratorin e UT-së/Administratorin e Njësisë kryesore përkatëse të UT-së, për marrjen e masave për sigurinë dhe rendin në institucion.

28. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

#### KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- |                     |           |
|---------------------|-----------|
| 1. Leticja Gusho    | (Kryetar) |
| 2. Arjan Tushaj     | (Anëtar)  |
| 3. Alnida Koroshi   | -//-      |
| 4. Eljon Doçe       | -//-      |
| 5. Etlon Peppo      | -//-      |
| 6. Shaniko Allajbeu | -//-      |
| 7. Dhurata Saraçi   | -//-      |

